



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 668/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Milija Bisevac, GI Zubin Potok, paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për shkak të keqpërdorimit në qendrën e votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.668/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Milija Bisevac, GI Zubin Potok, kundër Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve, për shkak të keqpërdorimit në vendvotimin Nr.2802/03D.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga Milija Bisevac, GI Zubin Potok, me të cilën pretendon se: Në vendvotimin 2802-03D, disa persona votuan përsëri (për herë të dytë), ndërsa disa u kthyen për shkak të ndërhyrjes së përfaqësuesve të GIZP, të cilët kishin marrë tashmë leje nga përfaqësuesit e vendvotimeve për të votuar. Për shkak të shkrimit të një deklarate për këtë dhe parregullsi të tjera, një anëtar i vendvotimit u ftua për bisedë jashtë ambienteve të vende votimit nga kryetari i KKZ -së. Ai mungoi për rreth gjysmë ore, pa zëvendësim. Ne besojmë se në këtë mënyrë qendra e votimit ishte pa mbikëqyrje, e të vetmes palë opozitare dhe se kështu procesi zgjedhor u rrezikua. Kishte gjithashtu sugjerime për votuesit për kë të votonin nga përfaqësuesit e vendvotimeve. Përfaqësuesi ynë i vuri në dukje këto parregullsi disa herë, por më kot, veprime të tilla vazhduan.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij në ankesë. PZAP, sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga ana e Policisë së Republikës së Kosovës, raport lidhur me parregullsitë e pretenduara në ankesë, ndërsa nga Raporti Polikor të cilin e ka dërguar Policia e Kosovës, nuk janë evidentuar parregullsi. Gjithashtu Paneli e shqyrtoi edhe Librin e Votimit për vendvotimin 2802B/03D, dhe nga i njëjti libër nuk ka evidentuar ndonjë parregullsi, ashtu siç pretendohet në

ankesë nga ankuesi. Në librin e votimit kemi vetëm përshkrimin dhe identifikimin e personave të cilët kanë votuar me asistencë për arsye të ndryshme, ndërsa në asnjë rast nuk kemi të evidentuar ndonjë parregullsi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e Milija Bisevac, GI Zubin Potok,, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës ka mospërputhje në mesë të pretendimeve në ankesë dhe konstatimeve nga libri i votimit të vendvotimit nr.1122B/01D.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.668/2021 më datën 20.10.2021

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi